



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 594/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër disa personave, për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik LVV, ne te cilën pretendohet se me datë 12.12.2010, në orën 15:15, në Llapushnik të Drenasit në QV Nr. 0317/E, disa persona kanë penguar përgjegjësin e votuesve tonë në këtë qendër duke ja mbyllur derën dhe duke goditur me shqelma, ku e gjithë kjo ngjarje ka ndodhur në prezencë të policisë. Përveç kësaj përgjegjësi ka qene duke i dorezuar ushqim vëzhguesve, mirëpo tek dera i hidhet ushqimi në tokë nga ana e atij personi që qëndronte tek dera. Sipas parashtruesit te ankesës ky rast është raportuar, por policia nuk ka reaguuar. Po në këtë QV nuk ka funksionuar spreji dhe llampat edhe pse është bërë ankesa në KKZ. Sipas parashtruesit te ankesës kjo përbën shkelje te nenit 34.1 te LPZ-se”.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, përveç se ka siguruar numër kontakt te Petrit Bajraktarit, shef i shtabit të Drenasit, në cilësinë e dëshmitarit.

Ne raportin e policisë me Nr. reference SPG/OP/10, te lëshuar nga togeri policor Fehmi Hoti, lënda “Njoftim lidhur me QV 0317/E në fshatin Llapushnik” theksohet se : “ në QV 0317/E në fshatin LLapushnik KK Drenas, sipas planit operativ ne nderrimin e paradites (05:00-17:00) kanë qenë të caktuar zyrtaret policore Tafil Shehu #5924 dha Haxhi Kiqina #6626”.

Nga raporti i oficerit te cilin e ka nënshkruar Tafil Shehu dhe Haxhi Kiqina polic, ceket se gjatë kohës sa ka qëndruar në këtë QV (nga ora 05:00-17:00) nuk ka vërejtur ndonje prishje te rendit dhe qetesis publike si dhe nuk ka pranuar ndonje ankesë nga menagjeri i kësaj QV-je. Poashtu sipas raportit te policise edhe ne radiologun Radiobazes se SP Drenas, nuk është pranuar ndonje informat apo anekese në lidhje me QV në fjalë

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar.**

Ankesa është e pabazuar për faktin se nuk është ofruar asnjë dëshmi apo prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar pasi që në ankesë nuk ceket se cilët kanë qenë ata persona të cilët kanë ushtruar dhunë mbi vëzhguesin, por vetëm se thuhet disa persona pa u ditur identiteti i tyre. Ky fakt konfirmohet edhe permes raportit te policisë me Nr. reference SPG/OP/10, ne te cilin theksohet se ne QV 0317 dt, 12.12.2010 nuk pasur asnjë problem sigurie PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 594/2010 më datën 16.12.2010.

